



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr. 42/2016

Prishtinë, më 16 nëntor 2016

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Nenad Rashiq, Shukrije Bytyçi dhe Etem Arifi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinatori i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Flora Kryeziu-UNICEF, Alketa Lasku-Tere des homes, Donjeta Kelmendi-KOMF, Sanije Berisha-OSBE, Visar Bivolaku-EVO/EUSR, Leunora Berbatovci-RTK.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj në vazhdim Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Avokatit të Popullit për vazhdimin e mandatit trevjeçar për zëvendësit e Avokatit të Popullit;

4. Shqyrtimi i peticioneve;

5. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Mytaher Haskuka tha se ka disa vërejtje të vogla në fjalimin e tij ku është diskutuar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për lirinë fetare në Kosovë.

Lidhur me këtë kryetarja tha se çdo vërejtje eventuale mund të rregullohet me administratën e Komisionit.

Kryetarja konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 26 tetor 2016, miratohet me sugjerimet e deputetit Mytaher Haskuka.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Kryetarja falënderoi anëtarët e Komisionit dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë për kontributet që kanë dhënë gjatë punëtorisë së mbajtur për këtë Projektligj dhe theksoi se jemi në rrugë të mbarë për të bërë një ligj sa më të mirë.

Propozimet të cilat i kanë marrë përsipër për t'i bërë në formë të shkruar në lidhje me disa nene të caktuara, organizata dhe institucionet, siç janë: "Save the Children", institucioni i Avokatit të Popullit, Koalicioni i organizatave për mbrojtjen e fëmijëve (KOMF) dhe Zyra Ligjore e MPMS-së, sot na kanë arritur, por nuk kemi pasur mundësi për t'i analizuar ato propozime. Kjo kërkon kohë, por besoj se në mbledhjen e radhës do ta shqyrtojmë këtë Projektligj, tani të gjitha i kemi të paraqitura në letër dhe do t'i trajtojmë të gjithë së bashku.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Avokatit të Popullit për vazhdimin e mandatit trevjeçar për zëvendësit e Avokatit të Popullit

Kryetarja tha se është e drejtë ligjore e Avokatit të Popullit për të propozuar për vazhdimin e mandatit për zëvendësit e Avokatit të Popullit. Por, për shkak të disa rrethanave të reja të krijuara në ndërkohë, që kanë të bëjnë me dorëheqjen e njërit nga zëvendësit e Avokatit të Popullit, z. Ibrahim Arslan, si Komision po e vlerësojmë më të arsyeshme, që Avokati i Popullit të shpallë konkurs për këto pozita dhe t'u jepet mundësia e kandidimit të gjithëve pa përjashtim, dhe të zgjidhen ata që e meritojnë.

Kryetarja hapi diskutimet lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Teuta Haxhiu tha se është mirë që Avokatit të Popullit, t'i rekomandohet shpallja e konkursit për zëvendësit e tij, sipas procedurave që janë paraparë me ligj.

Ligji nuk ua ndalon mundësin e konkurrimit edhe atyre që aktualisht janë zëvendës të Avokatit të Popullit.

Salihe Mustafa tha se zëvendësit e Avokatit të Popullit, kanë qëndruar në pozitë më shumë se një mandat, por me ligj e kanë pasur edhe këtë mundësi.

Është mirë që u sqarua lënda e zëvendësit të Avokatit të Popullit dhe dorëheqja e tij në mënyrë që mos të lindin keqkuptime.

Ajo përkrahu qëndrimin që t'i rekomandohet Avokatit të Popullit që të shpallë konkurs për zgjedhjen e zëvendësve të tij në një kohë sa me të shkurtër dhe gjithnjë duke respektuar dispozitat ligjore.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se ky propozim është proceduar në muajin gusht dhe tani jemi në muajin nëntor, nuk është e rrugës që të kthejmë prapë këtë propozim të Avokatit të Popullit dhe të shkojmë me propozim për konkurs. Ajo theksoi se mos prezenca e Avokatit të Popullit këtu na bën të kemi mendime të ndryshme. Lidhur me këtë çështje ajo ishte e mendimit që të shkohet me procedura në bazë të propozimit të Avokatit të Popullit.

Kujtim Paqaku, lidhur me këtë çështje, tha se duhet të respektohet ligji. Ai theksoi se ka lëvizje pozitive sa i përket shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave të komuniteteve në këtë institucion, dhe dëshiroj që edhe zëvendësit e Avokatit të jenë afër Avokatit të Popullit.

Punën apo mos punën eventuale të zëvendësve të Avokatit të Popullit e ka matur Avokati i Popullit, sepse ai është bashkëpunëtori i tyre më i ngushtë.

Më pas, kryetarja, sqaroi se lënda është proceduar në gusht, por është shtyrë për probleme të Institucionit të Avokatit të Popullit, i dimë arsyet dhe nuk po dua të thellohem në kronologji të ngjarjes, sidoqoftë ne duhet të dalim me një përfundim, pa dashur të imponojë mendimin e akujt.

Mytaher Haskuka tha se Avokati i Popullit është institucion i pavarur dhe sipas ligjit ai ka të drejtë të kërkojë vazhdimin e mandatit për zëvendësit e tij.

Ai theksoi se ka dilema për të vendosur pa prezencën e Avokatit të Popullit në këtë takim, dhe mos po prekim pavarësinë e Institucionit.

Mexhide Mjaku-Topalli shprehi mendimin që në këtë mbledhje të mos vendoset lidhur me këtë propozim, por të lihet hapësirë në prezencë të Avokatit të Popullit. Herën e kaluar nuk i kishim 5 emra në bllok edhe tani me dorëheqjen e njërit nga zëvendësit, prapë nuk i kemi 5 emra, por prapë do të vendosim së bashku.

Teuta Haxhiu tha se këtë propozim e kemi pasur edhe në mbledhjen e fundit të Komisionit. Avokati i Popullit në këto dy takime ka munguar, ndërsa ne nuk mund të pretendojmë se dikush ia vlen me mbetur në pozitë, e tjetri jo. Përderisa prej mandatit të kaluar merremi me rastin e z. Staletoviq, dhe unë kam kërkuar të procedohet në Kuvend, propozimi për shkarkim. Kanë kaluar disa vite dhe ne ende kemi dilema për shpalljen e konkursit, i cili nuk u ndalon konkurrimin edhe të zëvendësve aktual dhe nëse janë të suksesshëm edhe mund të propozohen për t'u zgjedhur, ndërsa për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit vendos Kuvendi.

Salihe Mustafa tha se është e mendimit që të shkohet me shpallje të konkursit, dhe se me këtë nuk do të ngecë puna në Institucionin e Avokatit të Popullit, sepse deri në zgjidhjen e zëvendësve të ri, zëvendësit aktual janë në detyrë.

Mexhide Mjaku-Topalli, mendon që është më mirë të pritët Avokati i Popullit për të dhënë sqarime, nëse ka mundësi të procedohet me atë zgjidhje, që të vazhdohet me tre kandidatë, e për dy pozitë të tjera të shkohet me shpallje të konkursit.

Kryetarja në vazhdim hodhi në votim propozimin që Avokatit të Popullit, t'i rekomandohet shpallja e konkursit për zëvendësit e Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

Rezultati i votimit ishte: katër vota për, një abstenim dhe një votë kundër.

Kryetarja konstatoji se Komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

Komisioni Funkcional i rekomandon Avokatit të Popullit që propozimi për zëvendësit e Avokatit të Popullit, të bëhet pas konkursit të shpallur nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

ARSYETIM

Meqenëse pas Propozim-vendimit nr. 63/2016 të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vazhdimin e mandatit 3 (tre) vjeçar për zëvendësit e Avokatit të Popullit, dt. 17.10.2016, janë krijuar rrethana të reja, siç është dorëheqja e z. Ibrahim Arslan, zëvendës i Avokatit të Popullit, i rekomandohet Avokatit të Popullit, shpalljen e konkursit për zëvendësit e Avokatit të Popullit, sipas procedurës ligjore të lartpërmendur.

4. Shqyrtimi i Peticioneve

Kryetarja, procedoi me kërkesën e banorëve të Fshatit Vranisht, Komuna e Dragashit, të cilët kanë shprehur pa kënaqësi të tyre për ndërtimin e hidrocentralit në fshatin e tyre dhe siç thonë ata, uzurpimi që u bëhet pronave private, ata e refuzojnë këtë duke u thirrur në të drejtën pronësore.

Për këtë mendoj se na duhet një informatë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Vendimi për ndërtimin e hidrocentralit është marrë nga autoritete shtetërore dhe nuk besoj se kanë bërë një shkelje të ligjit, ashtu siç pretendojnë ata banorë.

Hidrocentrali është i një rëndësie nacionale, por duhet me marrë për bazë edhe të drejtën e qytetarëve gjatë eksproprijimit të pronave, pra kemi nevojë për më shumë informata.

Teuta Haxhiu tha se si deputet kemi pranuar shumë herë ankesa të kësaj natyre dhe natyrave të tjera. Është mirë që në Komision të ftohet për raportim lidhur me këtë çështje dhe për shumë kërkesa të tjera, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Mytaher Haskuka tha se edhe në Prizren ka pasur reagime lidhur me këtë çështje, për shumë prej këtyre rasteve rezulton se qytetarët nuk janë konsultuar, ose janë mbajtur takime me nga tre- katër persona, kinse e kanë diskutuar projektin.

Pas përfundimit të diskutimeve për këtë çështje, kryetarja, konstatoi se për mbledhjen e radhës së Komisionit, të ftohet për raportim lidhur me këtë, z. Ferat Shala, U.D. ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kryetarja në vazhdim procedoi me ankesën e një banori nga fshati Rezallë, Komuna e Skenderajt, z. Sabit Hoxha, i cili ankohet se KEDS i ka vendosur një shtyllë të tensionit të lartë afër biznesit familjar dhe i ka pamundësuar shfrytëzimin e pronës, ai ka licencë që nga viti 2000, lënda është e kompletuar, për ta parë se sa është cenuar prona dhe biznesi familjar mendoj se drejtoria e shërbimeve publike e komunës mundet me na dhënë më shumë informacione.

Ne nuk mundemi me marrë një përfundim pa e pasur një sqarim se kjo ankesë a është e bazuar apo jo.

Mexhide Mjaku-Topalli, nga ajo çka është paraqitur në këtë ankesë, shihet qartë se është i rrezikuar objekti nga tensioni i lartë dhe është problem, formën se kujt me ju drejtuar për zgjidhje kjo është çështje që duhet diskutuar dhe vendosur.

Kryetarja tha se të gjitha këto janë paraqitur në ankesë por se a janë të bazuara duhet pyetur edhe organet kompetente, nuk po paragjykojmë, por ta shohim përgjegjësin e institucioneve, është mirë të informohemi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e Komunës së Skenderajt, lidhur me këtë lëndë a kanë ndërmarrë ata ndonjë procedurë për zgjidhje dhe se ku janë pengesat në zgjidhjen e këtij problemi, dhe nëse lënda është në gjykatë, cila është mundësia jonë, si Komision, për të vepruar.

Teuta Haxhiu, shtroi çështjen që Komisioni t'i drejtohet gjykatës, përmes një shkrese, që këtë lëndë ta trajtojë me prioritet.

Kujtim Paçaku tha se nuk është ky një rast i vetëm, kemi shumë e shumë raste të tjera që rrezikohet jeta e qytetarëve nga tensioni i lartë.

Mytaher Haskuka, theksoi se me këtë çështje po humbet kohë. Ai në vazhdim theksoi se KEDS e ka aprovuar kërkesën e palës për zhvendosje të linjës e cila duhet të realizohet brenda 180 ditëve. Ai e theksoi se nuk e kupton se ku qëndron problemi tani pasi që KEDS e ka aprovuar kërkesën e palës dhe pritet vetëm realizimi i saj.

Kryetarja, tha se është e nevojshme që t'i takojnë përgjegjësit për këtë çështje, në mënyrë që të vërtetohet saktësisht se si është situata. Ajo e kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit se kush është me rëndësi që të ftohet në mbledhjen e radhës së Komisionit, për të diskutuar lidhur me këtë çështje.

Komisioni vendosi që të ftohen përfaqësuesit e KEDS-it, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike e Komunës së Skenderajt.

5. Të ndryshme

Teuta Haxhiu, i informoi anëtarët e Komisionit se e ka vizituar qendrën strehuese të personave me paaftësi mendore në Deçan. Lidhur me këtë qendër ajo tha se do të jetë me rëndësi që të

vizitohet nga Komisioni, kurdo që ekziston mundësia për të verifikuar nga afër gjendjen e tyre. Në vazhdim ajo theksoi se në këtë qendër janë 6 (gjashtë) banorë që nuk posedojnë dokumente të identifikimit.

Do të ishte me rëndësi që Komisioni t'i vizitojë disa nga këto qendra për të parë realitetin që mbretëron. Përveç vizitës që e ka realizuar në këtë qendër ajo tha se ka informacione se Avokati i Popullit ka një raport lidhur me këtë çështje në të cilin përfshihen edhe qendrat e tjera dhe mbi këtë bazë do të jetë me rëndësi nëse me këtë çështje do të merret Komisioni, në të ardhmen. Lidhur me këtë qendër ajo i informoi anëtarët e Komisionit se aty kishte mungesa të stafit, por edhe të personelit mjekësor duke reflektuar kështu gjendjen e rëndë të tyre.

Kryetarja, lidhur me këtë çështje, tha se do të formojnë një Grup Punues dhe do të vazhdojnë me aktivitete në këtë drejtim, por gjithmonë duke respektuar vullnetin e anëtarëve të Komisionit. Mirëpo ajo ishte e mendimit që të diskutohet kjo çështje në takimin e datës 7 dhjetor ku do të rishikohen aktivitetet që pritet të realizohen në të ardhmen.

Teuta Haxhiu, kërkoi nga administrata e Komisionit që ta sigurojnë raportin e Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje dhe të ja dërgojnë anëtarëve të Komisionit.

Kryetarja tha se pasi që të analizojnë Raportin e Avokatit të Popullit lidhur me këtë kategori do të analizojnë mundësinë për veprime të metutjeshme.

Mexhide Mjaku-Topalli theksoi se është e nevojshme që të analizohen të gjitha rekomandimet e Avokatit të Popullit me qëllim të identifikimit se a janë përmbushur nga institucionet kompetente rekomandimet e dala nga Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit.

Kryetarja sqaroi se sa i përket kërkesës së organizatës “Handikos”, ajo nuk është futur në rend të ditës si pikë e veçantë, për shkak se me anë të një kërkesë do t'i drejtohem Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Pasi ta shqyrtojë Komisioni për Buxhet dhe Financa, atë kërkesë, varësisht se çka rezulton nga kjo, atëherë Komisioni për të Drejtat e Njeriut do të vendosë për hapat e mëtejshëm.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se është takuar me persona të kategorisë së tillë dhe gjendja e tyre është e vështirë. Ajo i informoi anëtarët e Komisionit se kategoria e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë kanë paralajmëruar protestë lidhur me zbatimin e neneve 7, 8, 9 dhe 13 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të cilat nene fillojnë së zbatuara nga data 1 janar 2017.

Salihe Mustafa përkrahu qëndrimin e kryetares së Komisionit, që me anë të një kërkesë t'i drejtohem Komisionit për Buxhet dhe Financa, me qëllim që çështja e kësaj kategorie të merret parasysh dhe të ndahen mjetet që janë të parapara me ligj.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni FunkSIONAL, i drejtohet Komisionit për Buxhet dhe Financa me këtë:

REKOMANDIM

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa, përfshirjen e kostos financiare të Ligjit nr.

Mytaher Haskuka, kërkoi që si Komision Parlamentar për të Drejtat e Njeriut të bëjnë një prononcim lidhur mbi ngjarjen e fundit në Burgun e Prizrenit, ku ka humbur jetën Astrit Dehari.

Ai si arsye përmendi obligimin e Institucionit Korrektues që të mbrojë të drejtën e jetës së secilit të burgosur, e që ka dështuar ta bëjë në këtë rast, pa marrë parasysh se si ka ndodhur rasti. Po ashtu ai tha se nga informacionet që posedon, familja ende nuk është njoftuar në mënyrë institucionale nga organet përkatëse për humbjen e jetës së Astrit Deharit, por vetëm i është dërguar trupi i tij. Lidhur me këtë ai theksoi se kjo përbën shkelje të rregullave, sepse familja duhet të njoftohet ose përmes letrave ose me telefon nga institucionet kompetente. Ai tha se në këtë rast është shkelur e drejta për informim. Po ashtu, ai tha se deklaratat kontradiktore dhe rrjedha e provave paraqesin shkelje të të drejtave të njeriut në aspektin e dinjitetit dhe privatësisë së familjes. Lidhur me këtë ai tha se kjo është shkelja e tretë që i është bërë familjes Dehari. Ai kërkoi që në lidhje me këto raste të ketë një prononcim nga ana e Komisionit. Komisioni duhet që të shpreh brengosjen e tij lidhur me këto ngjarje për të cilat ka reaguar edhe Avokati i Popullit lidhur me shkeljen e privatësisë dhe dinjitetit të familjes në lidhje me rrjedhjen e provave. Në vazhdim ai theksoi se sikur të kishte shfaqur shqetësimin e tij Komisioni, në arrestimin që është bërë shou mediatik, ndoshta nuk kishte ardhur deri te rasti në fjalë. Lidhur me këto raste ai ishte i mendimit që nuk është e drejtë që edhe pas 78 ditëve qëndrimi në burg akoma nuk janë marrë në pyetje nga ana e prokurorit e as nuk është ngritur ndonjë kallëzim penal ndaj tyre. Ai propozoi që nëse pajtohen anëtarët e Komisionit ai do të përpilojë një tekst, me qëllim të shprehjes së brengës së Komisionit rreth ngjarjeve të fundit që kanë ndodhur.

Teuta Haxhiu, duke u ndërlidhur me parafolësin, theksoi se ka qenë e shokuar nga ky rast, si nënë dhe si një deputete. Ajo tha se i ka shprehur ngushëllime familjes nëpërmjet rrjeteve sociale. Ajo theksoi se e përkrah çdo iniciativë që çon në zbardhjen e plotë të rastit në fjalë. Ajo tha se nga kjo ngjarje janë shokuar të gjithë duke dëshiruar që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Neglizhenca në zbardhjen e këtij rasti nuk i kontribuon qetësisë familjare dhe shoqërore në Kosovë. Në fund ajo e përsëriti gatishmërinë e saj për mbështetjen e çdo iniciative që çon në zbardhjen e shpejtë të saktë dhe të paanshme të këtij rasti për të cilën bëri thirrje që të zgjidhet sa më parë dhe të zbulohen shkaqet e vdekjes së tij.

Mexhide Mjaku-Topalli tha së të gjithë bashkërisht ndjejnë dhimbje për këtë rast. Ajo në vazhdim theksoi se mund të diskutohet në Komision, mirëpo përgjigjet dhe vendimet lidhur me rastet e tilla duhet t'i marrin nga institucionet kompetente. Ajo tha se është me rëndësi të lejohen institucionet ta kryejnë punën e vet dhe të japin përgjigje lidhur me këtë e pastaj Komisioni do të ketë mundësinë ta ngritë zërin nëse konsideron se ndonjë gjë nuk ka shkuar mirë.

Teuta Haxhiu, duke u ndërlidhur tha se kishte përmendur ndërhyrjen politike duke ju referuar kohës deri sa ka qenë në burg. Ajo në vazhdim tha se atë që ka përjetuar ajo sa ka qenë e arrestuar për dy dite në krahasim me këtë 78 ditë është papërgjegjësi totale e institucionit. Ajo duke mos dashur të interferojë në organet që merren me drejtësi tha se kanë dilemat e tyre

lidhur me këtë. Në fund ajo përsëriti qëndrimin e saj për gatishmërinë për mbështetje të çdo iniciative për zbardhjen sa më të shpejtë dhe të saktë të kësaj çështje.

Kujtim Paqaku, duke shfaqur keqardhjen e tij lidhur me këtë ngjarje tha se edhe komuniteti të cilit ai i takon, janë të shokuar me ngjarjen. Ai në vazhdim theksoi se janë në pritje të përgjigjes nga institucionet që merren me këtë çështje. Lidhur me këtë rast ai tha se komuniteti Rom janë të interesuar të diskutojnë dhe ta zbardhin këtë rast duke pasur parasysh se kjo mund t'i ndodhë secilit komunitet në Kosovë. Në fund ai tha se ka besim në institucionet e Kosovës që këtë rast do ta zbardhin në mënyrë që të vërtetohet se çka ka ndodhur në këtë vërtetë.

Salihe Mustafa, duke shprehur keqardhjen e saj lidhur me këtë rast tha se është shumë e rëndë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ajo në vazhdim tha se është me rëndësi që institucionet të kryejnë punën e tyre dhe të saktësojnë rrethanat që tregojnë se çka në të vërtetë ka ndodhur. Lidhur me këtë ajo tha se është me rëndësi që puna që bëhet të jetë e saktë, edhe nëse nuk bëhet në mënyrë të shpejtë.

Mytaher Haskuka, duke u ndërlidhur me bashkëbiseduesit tha se duke mos dashur të prejudikojnë asgjë në rrjedhën e hetimeve kërkon nga Komisioni që të reagojë për disa shkelje të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur në këtë rast. Ai në vazhdim tha se pa marrë parasysh rrethanat se si ka ndodhur vdekja institucioni ka dështuar të sigurojë të drejtën e jetës dhe në këtë rast është shkelur një e drejtë e njeriut. Ai po ashtu përmendi edhe mënyrën e rrjedhjes së provave në bazë të të cilave është cenuar e drejta e privatësisë dhe e drejta e familjes për dinjitet, këtë ai e tha duke u bazuar në rastet e qarkullimit të provave në televizion, ndërsa avokati nuk i posedon akoma ato prova. Ai kërkoi nga Komisioni që ta shprehë brengën e tyre për këto dy shkelje të cilat i theksoi më lartë. Ai këtë kërkesë e bëri duke u bazuar në shkeljet që kanë ndodhur e të cilat janë të garantuara edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut siç është e drejta e jetës dhe e drejta e privatësisë.

Kryetarja, duke u ndërlidhur me këtë çështje tha se të gjithë bashkërisht ndjejnë keqardhje për këtë rast të rëndë i cili ka ndodhur. Në vazhdim ajo tha se duke pasur parasysh që ky rast ka pasur përfundim tragjik është obligim i institucioneve të drejtësisë që të thonë fjalën e vet. Ajo po ashtu theksoi se një çështje e tillë është trajtuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit me kërkesën e disa deputetëve. Kryesia e Kuvendit me qëllim që mos të lëndojë procesin që po zhvillohet nga organet e drejtësisë nuk ka lejuar që të diskutohet për këtë çështje. Ajo tha se janë në mes të dilemave që ta shprehin një keqardhje për këtë rast, mirëpo, mos të ndërferojnë në organet e drejtësisë të cilat janë duke u marrë me këtë rast. Lidhur me këtë rast ajo njoftoi se ka kontaktuar Avokatin e Popullit, i cili e ka njoftuar që është duke e përcjellë tërë procesin duke filluar nga obduksioni. Ajo po ashtu theksoi se si Komision duhet të shohin atë çka edhe kanë kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit si mekanizëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Lidhur me këtë ajo tha se mund të vizitojnë Institucionin e Avokatit të Popullit me qëllim të marrjes së informacioneve rreth kësaj ngjarje që ka ndodhur. Ajo ishte e pajtimit se ka ndodhur shkelje me vetë faktin se ky rast ka përfunduar tragjikisht ku ka humbur jetën një person. Ajo po ashtu theksoi se shkelje ka pasur edhe nga mediat në lidhje me rrjedhën e informacioneve. Për këtë çështje ajo tha se edhe Ministria e Drejtësisë ka kërkuar përsheptimin e rastit në mënyrë që të mos trazohen edhe më shumë familjarët e viktimës. Lidhur me këtë ajo i propozoi Komisionit që të vizitojnë Institucionin e Avokatit të Popullit në mënyrë që të informohen më hollësisht me rrjedhën e këtij rasti e pastaj të vendosin për një deklaram të përbashkët.

Mytaher Haskuka tha se ata mund të ndërmarrin edhe veprime të tjera, mirëpo kërkoi që me një deklaratë publike Komisioni të shfaqë pakënaqësinë e tij lidhur me shkeljet që kanë ndodhur me këtë rast.

Kryetarja kërkoi nga anëtari i Komisionit, z. Mytaher Haskuka, që t'i prijë grupit në vizitën tek Avokati i Popullit, sepse më shumë informacione që do të marrin vetëm sa do t'i ndihmojnë Komisionit në veprimet e mëtutjeshme.

Mytaher Haskuka theksoi se Komisioni mundet të ndërmarrë edhe aktivitete të tjera, mirëpo kërkoi që ata të dalin me një deklaratë në mënyrë që të shfaqin reagimin e tyre lidhur me shkeljet që kanë ndodhur në këtë rast. Në fund ai kërkoi që ky propozim të vendoset me votat e anëtarëve të Komisionit, sepse siç tha ai një reagim i tillë është i nevojshëm që të bëhet nga ana e Komisionit.

Kryetarja, e përsëriti se një vizitë tek Avokati i Popullit do të ishte e nevojshme me qëllim të informimit sa më të mirë lidhur me rastin në fjalë. Lidhur me këtë ajo tha se ky takim e manifeston veprimtarinë, e po ashtu edhe keqardhjen e shprehur nga Komisioni për rastin e ndodhur.

Mytaher Haskuka, duke shprehur pakënaqësinë e tij me debatin theksoi se këto veprime mund të ndërmerren nga ana e Komisionit, mirëpo është e pamjaftueshme nëse nuk dalin me një reagim të tillë në cilësinë e Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Ai në vazhdim e përsëriti se në vazhdimësi bëhen shkelje të tilla duke filluar nga arrestimi i 6 aktivistëve pa fakte dhe pastaj mbajtjen e tyre për 78 pa i marrë në pyetje. Sipas tij këto shkelje vazhdojnë të ndodhin në vazhdimësi nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kryetarja tha se asnjëherë nuk gjykon rastet e arrestimit të personave nga ana e organeve të drejtësisë, duke i precizuar si arrestime të drejta apo të gabuara, dhe ishte e mendimit që duhet të jenë të matur në gjykimin e organeve të drejtësisë lidhur me raste të tilla të arrestimeve. Ajo tha se do të marrin më shumë informacione nga Avokati i Popullit lidhur me këtë rast dhe do të analizojnë mundësitë e veprimeve të mëtutjeshme.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI

